

PRIZREN

*my*

FAMILYJA

SHTOMEPIA

HISTORYJA

*im*



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

**Swiss Agency for Development  
and Cooperation SDC**

Ky grant është financuar nga projekti Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) – i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF)



## PRIZRENI

familja ime my family

shtëpia ime my home

historia ime my story

2018

PRIZRENI  
familja ime, shtëpia ime, historia ime

PRIZRENI  
my family, my home, my story

Botues: EC Ma Ndryshe  
Rr. Saraçët 5, 20000/Prizren  
Bulevardi Nënë Tereza, H 30 B1 Nr. 5, 10000/Prishtinë  
[www.ecmandryshe.org](http://www.ecmandryshe.org) & [info@ecmandryshe.org](mailto:info@ecmandryshe.org)  
029-222-771 & 038-224-967



Prizreni – Një kryevepër e  
ndërtuesve të panjohur

*Artikull nga Arhitektura i Urbanizam  
1964 – 95, Beograd 1971*

Prizren – Mater Piece of  
Unknown Builders

*An Article from Arhitektura i  
Urbanizam 1964 – 95, Belgrade 1971*

Bashkim Fehmiu, arkitekt

Qyteti është një medium në të cilin shpalosen proceset e jetës së kondensuar njerëzore. Ky medium është i kushtëzuar nga ambienti ekonomik, teknik, natyral, social, estetik dhe intelektual.

E vjetra dhe e reja kriojnë një proces unik të klimës së këtij mediumi.

Spontaniteti në origjinë, me posedim

Bashkim Fehmiu, architect

Town is a medium in which unfolds the process of condensed human life. This medium is conditioned by the natural, economical, technical, social, aesthetical and intellectual climate.

The old and new form a unique process of the climate of the medium.

Spontaneity in originating, with the possession of a highly elaborated

të një ndjeshmërie shumë të përpunuar, për karakteristikat natyrore (situacioni, konfigurimi i terrenit, klima, uji etj.) janë rezultat i konformitetit me kërkesat e këtyre faktorëve të nxjerrura në mënyrë empirike, të cilat direkt ndikojnë në konceptimin e procesit, si iniciator i përhershëm i kontrasteve të brendshme dhe të sistemit në korelacionin e shoqërisë, hapësirës, teknologjisë, drejt një progresi të vazhdueshëm nga iracional në racional, nga fiktiv në realitet, nga realiteti i drejtpërdrejtë deri tek ndërmjetësimi - vlerat e parashikimit më të lartë dimensional të shfaqura në marrëdhëniet harmonike.

MAHALLA (komunitetet e banimit në kuadër të njësive të lagjes) si njësi strukturore e qytetit, përbente një kategori të veçantë, duke u diferencuar edhe nga marrëdhëniet e përcaktuara shoqërore të përkatësisë. Komplekset e banimit, rrjeti i trafikut me një ngatërrresë të pazakontë të arterieve, rrugëve, korsive, rrugicave pa krye, të cilat në konvergjencat e tyre tani po bëhen më të gjera, tani më të ngushta, tani

sensibility, for natural characteristics (situation, configuration of the terrain, climate, water, etc.) are a result of the conformity with the requirements of these, empirically learnt factors, which directly influence the conception of the process, as the permanent originator of inner contrasts and of the system in correlations society, space, technology, towards a continuous progress from the irrational to rational, from the fiction to the reality, from the direct reality to the mediation – values of the stated higher dimensional projection of harmonious relations.

MAHALLA (housing communities of neighborhood units) as structural units of the town, constituted a special category, differentiating themselves also by determined social relationship of belonging. The housing complexes, the traffic network with a strange entanglement of arteries, streets, lanes, blind alleys which, in their convergences, becoming now wider, now narrower, now rising and now descending, make the basis of conceiving of



**Pamje e Prizrenit të lashtë**  
Burimi: i panjohur  
Viti: i panjohur

**View of ancient Prizren**  
Source: Unknown  
Year: Unknown

në rritje dhe tani në rënje, përbëjnë bazën e konceptimit të strukturës.

ÇARSHIA e vendosur në qendër të indit urban, e zgjeruar sipas llojeve të aktiviteteve, duke filluar nga bërthama e qytetit - Shadërvani, të cilës iu bashkua kujunxhillëku (dyqane të vogla argjendarie të shpërndara në të dy anët e rrugës) përskaj Urës së Gurit. Me rrjetin e rrugëve, rreshtat e dyqaneve, çarshia përfaqëson një tërësi jashtëzakonisht të vlefshme si një hapësirë ku ishin të vendosura ndërtesat në të cilat ata tregtonin në katin përdhesë dhe punonin në katin e sipërm. Pas këtyre dyqaneve ishin të vendosura depot.

SHTËPIA në Prizren pasqyronte cilësinë e lartë të kulturës së banimit, në të cilën funksioni është në përputhje me qëllimin. E vendosur në parcela të formave të parregullta ajo arriti me vetitë e saj hapësinore një shkallë të jashtëzakonshme të përbërjes së lirë. Duket në kopsht, e rrethuar me mure dhe e tërhequr nga rruga, duke u sigruuar kështu kurioziteti i kalimtarit. Sytë si aplikim i

structure.

ÇARSHIJA (market place) situated in the center of the urban tissue, extended according to the kinds of activities, starting from the nucleus of the town – Shadërvan, to which was joined the kujunxhillëk (goldsmiths' quarter) and further, across the stone bridge. With its network of streets, its rows of shops, çarshija represents an exceptionally valuable whole as the area of one storeyed buildings – where they worked and traded in the ground floor and worked on the upper floor. Behind these shops, leaned against them, there were the warehouses.

The HOUSE at Prizren reflected the high quality of the housing culture, in which the function is in conformity with the purpose. Located on plots of irregular forms it reached, with its spatial properties an extraordinary degree of free composition. It looks out in the garden, walled in and drawn in from the street, securing itself thereby from the curiosity of passers-by. The eyes as the application of slight twisting, makes



Pamje e Prizrenit të dikurshëm, nën rrjedhjen e Lumbardhit, Kalasë së Prizrenit në prapavijë si dhe Lagjes së Nënkalasë

Burimi: i panjohur

Viti: i panjohur

The view of the old Prizren, with the spot on Lumbardi stream, Prizren Fortress and Nënkalaja neighbourhood in the background.

Source: Unknown

Year: Unknown

shtrembürimit të lehtë, e bëjnë motivin përfundimtar të dimensionit të lartë të shtëpive, të zhytur në ngazëllimin hapësinor.

Shtëpitë janë të ndërtuara me materiale të lehta në katet e sipërme, ndërsa dyshemeja në tokë është prej guri ose prej një muri mjaft të trashë të tullave të thara në diell me hapje të proporcioneve harmonike. Materiali i ndërtimit mbetet i njëjtë, por format dallojnë në pjesë të ndryshme të qytetit dhe për këtë shkak rrjedhin disa efekte të ndryshme të fenomenit të strukturës, atmosferës, formimit të objekteve të ndërtuara me përmasë të njeriut.

Për hir të ndërtimit të "ri", strukturat unike dhe ambientet janë zhdukur dhe ende po zhduken. Qytetërimi i epokës sonë është i paprecedent, i pamëshirshëm, shkatërron gjithçka para vetes. Ne ndoshta nuk do të arrijmë më kurrë të ndërtojmë struktura të tillë të gurit, dheut dhe drurit. Ky Prizren tanë po zhduket dhe demolohet nga forcat elementare. Shumë arsyë për procedurat e rinovimit - nga mbrojtja, rikthimi,

the final motif of high dimension of houses, immersed into the spatial exultation.

The houses are constructed of light materials on upper floors, while the ground floors are either of stone or of a rather thick wall of sun-dried bricks with openings of harmonious proportions. Building material remains the same, but the forms are different in various parts of the town and on this account there arise dissimilar effects of the phenomenon of structure, atmosphere, formation of buildings constructed measuring by the human ell.

At Prizren ruled, as an imaginary motto, the relation cause-consequence-life, forming built in logic and rationally of invention of the intuitive, in the fizarrenes of the concrete as well as organic building in the abstraction of structural frames of volumes where life plays with nature in its givenness. For the sake of constructing the "new", the unique structures and ambiencies have disappeared and still disappear. Civilization of our epoch is



**Pamje e Lagjes Arasta nga gjendja burimore e saj, e cila pësoj ndryshime rrënjosore pas Luftës së Dytë Botërore**

Burimi: i panjohur  
Viti: i panjohur

**The view of Arasta neighborhood in its initial state, which suffered radical changes after the Second World War**

Source: Unknown  
Year: Unknown

rindërtimi dhe ristrukturimi i vlerave, megjithëse "lënë pas dore" janë domosdoshmëritë për nevojën e ndërhyrjeve. Në këtë drejtim besoj se Prizrenit i është bërë padrejtësi! Koncepti i rritjes organike duhet të ketë qenë, sipas mendimit tim, ideja kryesore për vlerat që do të drejtoheshin drejt një bashkimi harmonik si për shembull: shfaqet e vjetra si kontrast, e cila do të eliminonte ndërprerjen dhe fragmentaritetin. A është shpirti i trashëgimisë dhe bollëkut të formave në rajonin e butë të kodrës së Kalasë, nëse vëllimet e ngathta të analizave të artikuluara kanë arritur në bërthamën e dështimeve të suksesshme të ndërhyrjeve të ekspertëve. (Arch. Stanko Mandič - planer).

Fillimi i së Resë mbi të Vjetrën është një procedim brutal i cili nuk ka marrë parasysh vlerat dhe nuk ka deklaruar projekcionet polidimensionale të marrëdhënieve të harmonizuara. Nuk është këtu çështja e entuziazmit sentimental dhe romantik!

unprecedentedly merciless, it destroys everything in front of itself. We should probably never more manage to built such structures of stone, earth and wood. This Prizren now is vanishing, demolished by elemental forces. Many reasons for proceedings of renovation – from protection, over preservation, restoring, reconstruction and restructuring of values, though "materially neglected", are the imperatives of the necessity of interventions. In this respect I believe that Prizren has been done injustice! The conception of organic growth and joining must have been, in my opinion, the leading idea for the values which would be directed towards a harmonious joining as, for instance: new – beside, in addition to, round the old as contrast, which would eliminate the discontinuity, fragmentarity and lack of aims. Is it the spirit of inheritance and abundance of forms in the gentle hill region of Kaljaja if the clumsy volumes of in articulated analyses have landed into the nucleus successful failures of expert interventions. (Arch. Stanko Mandič –

Ne gjejmë ngushëllim në evazionin e pandërprerë të gjërave, sepse kjo është gjithashtu një lëvizje. Prandaj ne duhet të njihem me forcat që veprojnë në mënyrë që një organizëm i denjë i qytetit të krijohet pa skema dhe kuazi-frymëzime nga format e trashëguara, pa rrezikuar ruajtjen e shpirtit të Prizrenit, atmosferën e ambientit, grupeve të lagjeve, autenticitetin e natyrës, format në transformimin evolues të jetës bashkëkohore në përcaktimin dhe thelbin e ndjenjës së formimit të shprehur në logjikën aktuale të rritjes së tërë HABITAT-it dhe URBANITETIT.

Ndoshta një mënyrë e tillë e shikimit të Prizrenit si një aglomeracion unik dhe specifik që është ndërtuar nga forcat efektive të kreativitetit anonim e bën të denjë të jetë një qytet nga i cili i rrezatohen frymëzimet për të rejën në sinjeritet për shkak të një shkalle më të lartë të cilësisë të shfrytëzimit dhe funksionit, të organizimit hapësinor, të strukturave dhe të ndërtimeve.

Kështu ne po e lëmë Prizrenin,

town planner).

The proceeding NEW upon the OLD is a brutal proceeding which did not take into account the values and did not state the polydimensional projections of harmonized relationships. It is not the question here of a sentimental and romantical enthusiasm!

We find comfort in the incessant evasion of things, because it is also a motion. Therefore we have to get acquainted with forces which act in order that a worthy organism of the town might be created without schematism and quasi-inspirations by the inherited forms, without imperiling to maintain the spirit of Prizren, the atmosphere of the ambience, groups of neighborhoods, authenticity of nature, forms in evaluative transformation of the contemporary life in the determination and essence of the sense of forming expressed in the logical current increasing whole of the HABITAT and the URBANITY.

Perhaps such a way of looking at

qytetin e bukurive të zhdukura me një vajtim për të renë, duke u menduar nëse do të kemi forca të mjaftueshme për të kapërcyer të vjetrën?

ÇFARË KEMI PASUR – ÇFARË KEMI HUMBUR!

ÇFARË KEMI TË RE – ÇFARË KEMI PËRFITUAR

Prizren as a unique and specific agglomeration which has been built by effective forces of the CREATIVE – ANONYMOUS makes it worthy being a town from which there radiate the inspirations for the new in sincerity owing to a high degree of quality of the utility of function, to the spatial organization, to structures and constructions. Formal aesthetic manner of expressing. Ode of the singing man's space from the biological to the psychological, it experienced through the conceptions of the organic in the synthesis of the matter and spirit in a united effect of the spatiality flowing through time.

Thus we are leaving Prizren, town of disappearing beauties with a lament for the new, wandering whether we shall have forces enough to surpass the old?

WHAT WE HAVE HAD – WHAT WE HAVE LOST!

WHAT WE HAVE GOT NEW – WHAT WE HAVE OBTAINED



*my*  
PRIZRENI  
*in*

## Prizreni – Memorje kolektive në venitje

Duke kërkuar në gjurmët e një kujtese kolektive jo shumë të vonshme, ky konkurs fotografie është realizuar me qëllim të dokumentimit të qytetit të Prizrenit në rrethana të ndryshme sociale nga ato që gëzon sot. Konkursi i hapur nga EC Ma Ndryshe ka ftuar të gjithë qytetarët e Prizrenit të cilët posedojnë fotografi të shkrepura para vitit 1990, t'i dhurojnë ato për t'i bërë pjesë të një katalogu i cili bashkarisht prezenton tri kategori të ndryshme fotografishë, ato të përfshirë në kapitullin "Familja ime", "Qyteti im" dhe Historia ime".

Një numër i konsiderueshëm qytetarësh i është përgjigjur thirrjes, duke ndarë me lexuesit e mundshëm pjesë nga e kaluara e tyre, e kaluara e parardhësve të tyre apo nga

## Prizren – Collective memories in the fade

Looking back at the footsteps of a recent collective memory, this photo competition was conducted with the purpose of documenting the city of Prizren in different social circumstances from what it enjoys today. The open competition by EC Ma Ndryshe has invited all citizens of Prizren who have pictures taken before 1990, to donate them in order to become part of a catalog that jointly presents three different categories of photographs, those of including in the chapter "My Family", "My Town" and "My Story".

A considerable number of citizens have responded to the call, sharing with potential readers parts of their past, stories of their ancestors, or third-person characters as part of the

personazhe të treta pjesë e kolazhit të fotografive që ata kanë poseduar. Fotografi nga jeta familjare, ngjarje në shtëpitë individuale, ngjarje nga jeta publike dhe sociale, evenimente të ndryshme të organizuara në qytetin e Prizrenit, janë disa nga momentet të cilat shpalosen përmes këtyre fotografive.

Përmes momenteve të dokumentuara në këto fotografi, dëshmohet edhe njëherë pasuria historike dhe kulturore e qytetit te Prizrenit. Fatkeqësisht, një numër i konsiderueshëm i objekteve dhe ambienteve të dokumentuara në këto fotografi tashmë nuk ekzistojnë, si rezultati dëmtimeve të vazhdueshme që trashëgimia kulturore e Prizrenit ka pësuar viteve të pas-luftës. Prandaj ky katalog, përveç vënies në fokus të vlerave që qyteti i Prizrenit ka trashëguar ndër gjenerata, bën thirrje në mobilizimin e fundit të mundshëm për mbrojtje të vlerave historike dhe kulturore të qytetit të Prizrenit.

collage of photos they have possessed. Photographs from family life, events in individual homes, events from public and social life, various events organized in the city of Prizren, are some of the moments that unfold through these photographs.

Through the moments documented in these photographs, the historic and cultural richness of the city of Prizren is well documented. Unfortunately, a considerable number of buildings and environments documented in these forgeries no longer exist, as the result of the continuous damage that Prizren's cultural heritage has undergone post-war years. Therefore, this catalog, apart from focusing on the values that the city of Prizren has inherited from generation to generation, calls for the last possible mobilization in the protection of the historical and cultural values of the city of Prizren.

*my* FAMILYJA  
*ime*





1962, Prizren , Kosovë. Bardh e zi, 14x8 cm

Fotografia është realizuar nga z. Muhamed Shukriu, në oborrin e Gazi Mehmet Pashës - Xhamia e Bajraklisë. Në foto janë znj. Margarita me dy fëmijët e saj Edi dhe Gem Shukriu, së bashku me mikeshën Drita Dobroshi dhe dy miqtë e tjerë të ardhur nga Shqipëria.

Statusi aktual: Ekziston  
Zotëruese: Voltisa Shuriu Berisha

1962, Prizren, Kosovo. Black and white, 14x8 cm

Photography is carried out by Mr. Muhammad Shukriu, in the courtyard of Gazi Mehmet Pasha - Bajrakli Mosque. In the picture are Mrs. Margarita with her two children Edi and Gem Shukriu, along with her friend Drita Dobroshi and two other friends coming from Albania.

Current Status: Existant  
Owner: Voltisa Shuriu Berisha

**1945-46, Shemsidin Kirajtani  
me shokë tek Shtëpia e  
Popullit, Prizren, Kosovë.  
Bardh e zi, 6x9 cm**

Në këtë sallë e cila është njohur si "Shtëpia e popullit" (tani salla e Edukatës Fizike, Gjimnazi "Gjon Buzuku"), në vitin 1946 ishte mbajtur procesi gjyqësor kundër 27 të akuzuarve të Ballit Kombëtar, me prokuror Ali Shukriu. Me 25 nëntor të këtij viti dënohen me pushkatim Marije Shllaku, At Bernard Llupi dhe Gjergj Martin Kolë Parubi, ndërsa të tjerët me 1-12 vjet burgim.

Statusi aktual: Ekziston  
Zotëruese: Fellanza Kirajtani

**1945-46, Shemsidin Kirajtani  
with friends at the House of  
People, Prizren, Kosovo.  
Black and white, 6x9 cm**

In this hall, known as the "House of the People" (now the Physical Education Hall, "Gjon Buzuku" Gymnasium), in 1946, the prosecution was held against 27 counts of Balli Kombëtar (The National Front), with Prosecutor Ali Shukriu. On November 25 this year were executed by shooting Marije Shllaku, Father Bernard Llupi and Gjergj Martin Kolë Parubi, while others were punished with 1-12 years of imprisonment.

Current Status: Existant  
Owner: Fellanza Kirajtani





**1962, Prizeni qytet i diversitetit, Prizren, Kosovë. Bardh e zi, 13 x 8.5 cm**

Pranë shtëpisë tradicionale prizrenase, familjarë të komunitetit shqiptar dhe turk pozojnë së bashku me fqinjët e tyre serb, duke vënë në pah diversitetin për të cilin qyteti i Prizrenit dallohet. Në prapavijë spikaten dritaret tradicionale, kapixhiku dhe oborri me gurë natyral të kësaj shtëpie prizrenase e cila më nuk ekziston. Në rendin e parë qëndojnë gjyshi dhe gjysja e Fatime Toskës (fëmiut me të bardha), përcjellur nga prindërit dhe vëllau.

Statusi aktual: Nuk ekziston  
Zotëruese: Enes Toska

**1962, Prizren, the town of diversity, Prizren, Kosovo. Black and white, 13 x 8.5 cm**

Near the traditional Prizren house, family members of the Albanian and Turkish community pose together with their Serb neighbors, pointing to the diversity for which the city of Prizren is distinguished. In the background are the traditional windows, the traditional door and the natural stone yard of this prehistoric house which no longer exists. In the first row are the grandfather and the grandmother of Fatime Toska (the child with white), followed by parents and brother.

Current Status: Existant  
Owner: Enes Toska

**8 qershor 1943, Pëllumbi i paqes në oborr të shtëpisë së Kirajtanëve, Prizren, Kosovë. Me ngjyra, 8x13 cm**

Dy vëllezërit Kirajtani: Shemsedini (në të majtë) dhe Xhaferi (në të djathtë) me pëllumbin e bardhë në dorë, shihen të buzëqeshur në oborrin e shtëpisë së tyre. Ky moment i kapur mjeshtërisht, tek secili arrinë të përcjellë një mesazh paqeje e ndjenjë lumturie.

Statusi aktual: Ekziston  
Zotëruese: Fellanza Kirajtani

**June 8, 1943, The Peace Pigeon in the Courtyard of the Kirajtan's House, Prizren, Kosovo. Colored, 8x13 cm**

Two Kirajtani brothers: Shemsedin (on the left) and Xhafer (on the right) with the white pigeon on their hands are seen smiling in their backyard. This moment neatly captured, succeeds in conveying to each one a message of peace and a sense of happiness.

Current Status: Existent  
Owner: Fellanza Kirajtani



**1957, Vizitë në Kalanë e Prizrenit, Prizren, Kosovë.  
Bardhë e Zi, 9 x 14 cm**

Fotografia është shkrepur gjatë vitit 1957. Në fotografi shihet Margarita Mjeda Shukriu së bashku me fëmijët e saj, Gemin dhe Edin, gjatë vizitës që po i bën Kalasë së Prizrenit. Në prapavijë shihet silueta e qytetit të Prizrenit, me theks në lagjen e Ralinit.

Zotëruese: Valtida Shukriu Marseli

**1957, Visit to the Fortress of  
Prizren, Prizren, Kosovo.  
White and Black, 9 x 14 cm**

This picture was taken in 1957. Here is seen Margarita Mjeda Shukriu, together with her children, Gem and Edi during their visit to the Fortress of Prizren. In the background one can see the silhouette of the city of Prizren, with the spot on Ralin neighborhood.

Owner: Valtida Shukriu  
Marseli





1968, Vizita e parë te prindërit, Prizren, Kosovë. Bardh e zi, 8.5x6.5 cm

Pritja e miqve në familjen Kryeziu. Ardhja tek shtëpia e prindërve pas javës së dytë të martesës. Myvedete Basha, Sakine Basha, Liza Krasniqi, Ajnishah Kryeziu, Xhemile Qerreti.

Statusi aktual: Ekziston  
Zotërues: Kreshnik Basha

1968, First Visit to Parents house, Prizren, Kosovo. Black and white, 8.5x6.5 cm

The reception of friends in Kryeziu family. Coming to the parents' house after the second week of marriage. Myvedete Basha, Sakine Basha, Liza Krasniqi, Ajnishah Kryeziu, Xhemile Qerreti.

Current Status: Existant  
Owner: Kreshnik Basha

**1981, Shtëpia e familjes Fusha, Prizren, Kosovë. Bardh e zi, 5x7 cm**

Në oborrin e shtepisë së familjes Fusha kanë pozuar gjyshja, nana, tezja dhe dy dajallarët e Gencer Tartar. Shtëpia e Ejub Fushës është ndërtuar në vitet 1900, ndërsa u rrënuar në vitin 1991. Shtëpia kishte 2 dhoma dhe një oborr të madh.

Statusi aktual: Nuk ekziston  
Zotërues: Gencer Tatar

**1981, The House of Fusha Family, Prizren, Kosovo. Black and white, 5x7 cm**

In the garden of Fusha Family have posed the grandmother, granddaughter, aunt and two uncles of Gencer Tartar. The Ejub Fusha House was built in the 1900s and was demolished in 1991. The house had 2 rooms and a large yard.

Current Status: Non-Existent  
Owner: Gencer Tatar





**Qershori 1968, Vizitë në shtëpinë e vajzërisë, Prizren, Kosovë. Bardh e zi, 18x12 cm**

E bija e familjes Kryeziu, tashmë znj. Myvedete Basha, gjatë vizitës në shtëpinë e prindërve të saj për herë të parë si nuse, dy javë pas ditës së martesës. Ajo shihet e shoqëruar nga bashkëshorti Ramadan Basha duke ecur nëpër oborrin ku e ka kaluar fëmijërinë drejt derë së shtëpisë së saj të vajzërisë.

Statusi aktual: Ekziston  
Zotërues: Kreshnik Basha

**June 1968, Visit to the maiden's house, Prizren, Kosovo. Black and white, 18x12 cm**

The daughter of Kryeziu family, now Mrs. Myvedete Basha, visiting her parents' home for the first time as a bride, two weeks after the wedding day. She is seen accompanied by her husband Ramadan Basha walking through the yard where she has passed her childhood to the door of her maidenhood home.

Current Status: Existant  
Owner: Kreshnik Basha

**1981, Shtëpia e familjes  
Deliri, Prizren, Kosovë.  
Bardh e zi, 5x7 cm**

Në oborrin e shtëpisë së z.Hysin Deliri kanë pozuar e ema e Gencerit, dajallarët dhe fëmijët e hallës. Kjo shtëpi është pesëdhomëshe dhe është ndërtuar rreth vitit 1920, ndërsa në vitet e 2000-ta është ndërtuar edhe një shtëpi e re në oborrin e saj, ku më parë ishte e vendosur një çezmë e cila më nuk ekziston.

Statusi aktual: Ekziston  
Zotërues: Gencer Tartar

**1981, Deliri Family  
House, Prizren, Kosovo.  
Black and white, 5x7 cm**

In the backyard of Mr. Hysin Deliri's house, Gencer's mother, uncles and cousins have been posed. This home has five rooms and was built around 1920, while in the year 2000 a new house was built in its yard, where previously was located a traditional tap which no longer exists.

Current Status: Existant  
Owner: Gencer Tartar



**1965, Shatërvan,  
Prizren, Kosovë. Bardh  
e zi, 12x18 cm**

Dy vëllezërit Kujtim Rrema - Xërxa (në të djashtë), student i stomatologjisë në Beograd, dhe Dashnor Xërxa (në të majtë), student i Akademisë së Muzikës në Sarajevë, qëndrojnë të ulur në Shatërvan. Në prapavijë vërehen dy qane artizanale dhe gra me veshje tradicionale. Fotografia është shkrepur gjatë pushimeve të tyre verore në Prizren.

Statusi aktual: Ekziston  
Zotërues: Sandër Xërxa

**1965, Shatërvan,  
Prizren, Kosovo. Black  
and white, 12x18 cm**

The two brothers Kujtim Rrema - Xërxa (right), a student of dentistry in Belgrade, and Dashnor Xërxa (left), a student of Sarajevo Academy of Music, are sitting in Shatërvan. In the background there are craft shops and women with traditional clothing. The photo was taken during their summer vacation in Prizren.

Current Status: Existant  
Owner: Sandër Xërxa



**22 mars 1983, Ditë e lumtur në  
familjen Grazhda, Prizren,  
Kosovë. Me ngjyra**

Duke festuar përfundimin e dimrit, të buzëqeshur shihen Daut Grazhda (i ndjerë) me hallën e tij Zeqijen. Pas shpërnguljes së katragjyshes së Adeas, së bashku me djemt e saj, nga Shqipëria në Kosovë, ata e ndërtojnë këtë shtëpi e cila tashmë vazhdon të jetë trashëgimi e familjes Grazhda.

Statusi aktual: Ekziston  
Zotëruese: Adea Grazhda

**March 22, 1983, Happy Day in  
Grazhda family, Prizren,  
Kosovo. Colored**

Celebrating the end of winter, Daut Grazhda with his aunt Zeqije. After the migration of Adeas's great-grandmother, along with her sons, from Albania to Kosovo, they build this house which is now the legacy of Grazhda family.

Current Status: Existant  
Owner: Adea Grazhda





**1965, Ditë pranvere në Landovicë, Prizren, Kosovë. Bardh e zi, 18 x 12 cm**

Vellezërit Xërxa, Dashnori dhe Kujtimi, presin në vizitë kushërin e tyre nga Gjakova, Skender Polloshkën. Në prapavijë shihet se si prizrenasit shfrytëzojnë këtë ditë të bukur për të kaluar kohë me familjet e tyre në bukuritë natyrore që e rrethojnë Prizrenin

Statusi aktual: Ekziston  
Zotërues: Sandër Xërxa

**1965, On a Spring day in Landovica, Prizren, Kosovo. Black and white, 18 x 12 cm**

Brothers Xërxa, Dashnori and Kujtimi, visit their cousin from Gjakova, Skender Polloshka. In the background it is seen how Prizrenians used this beautiful day to spend time with their families in the natural beauties surrounding Prizren.

Current Status: Existental  
Owner: Sandër Xërxa



**23 gusht 1981, Ceremoni martese, Prizren, Kosovë. Me ngjyra, 13.5x10 cm**

Martesa e Gazmend dhe Vjollca Krajkut në Verën e vitit 1981 mbahet si kujtim me anë të kësaj fotografie të shkrepur gjatë kalimit të tyre përgjatë rrugicës që shpie në oborr të shtëpisë.

Statusi aktual: Nuk ekziston  
Zotëruese: Malbora Krajku

**23 August 1981, Wedding Ceremony, Prizren, Kosovo. Colored, 13.5x10 cm**

The marriage of Gazmend and Vjollca Krajku in the Summer of 1981 is held as a reminder through this photograph during their passage along the alley that leads to the yard of the house.

Current Status: Existant  
Owner: Malbora Krajku

*my* SHTOMEPIA *ime*





Shtëpia e familjes Pomaku, Rruga "Saraçët", Prizren, Kosovë. Bardhë e zi, 10.5 x 7.5 cm

